



Prishtinë, 30 Dhjetor 2010

Nga: **Dr. Ali Hamiti**, Kryesues i Bordit të ZRRE-së

Për: **Z. Arben Gjukaj**, Drejtor Menaxhues, KEK sh.a

Kopje: **Znj. Justina Pula-Shiroka**, Ministre e Energjisë dhe e Minierave

Z. Ismet Krasniqi, Sekretar - Kuvendi i Kosovës

Z. Petrit Pepaj, Drejtor për Tarifa dhe Çështje Rregullative, KEK sh.a

Lënda: Shqyrtimi i pestë i tarifave të energjisë elektrike (SHTE5)

Të nderuar,

Po ju njoftojmë lidhur me planin e realizimit të Shqyrtimit të pestë të tarifave të energjisë elektrike (SHTE5), që ka të bëjë me tarifat dhe ngarkesat e reja që do të hyjnë në fuqi dhe do të zbatohen nga data 1 prill 2011.

Siç jeni në dijeni, ligjet e reja për Sektorin e energjisë kanë hyrë në fuqi më 1 dhjetor të këtij viti, dhe legjislacioni sekondar për implementimin e këtyre ligjeve duhet të kompletohet brenda nëntë muajsh. Gjatë kësaj periudhe kohore, ZRRE-ja do të identifikojë ndryshimet e nevojshme në legjislacionin sekondar si pasojë e ndryshimit të ligjeve, duke përfshirë këtu edhe legjislacionin që ka të bëjë me rregullimin e tarifave. Për këtë arsye, ky shqyrtim tarifor do të realizohet në bazë të legjislacionit sekondar ekzistues.

Orari tentativ për SHTE5 është si vijon:

- 06 janar 2011: Dërgimi nga ZRRE i formularëve të aplikacionit për tarifa.
- 28 janar 2011: Dorëzimi i aplikacioneve të tarifave nga të licencuarit.
- 18 shkurt 2011: Publikimi i aplikacioneve për tarifa dhe vlerësimi i tyre nga ZRRE-ja, si dhe propozimet e ZRRE-së për tarifat e rregulluara dhe për ngarkesat.
- 4 mars 2011: Afati i fundit për dorëzimin e komenteve nga palët e interesit, lidhur me vlerësimet e ZRRE-së.
- 16 mars 2011: Publikimi i përgjigjeve të ZRRE-së lidhur me komentet e të palëve të interesit.
- 23 mars 2011: Vendimi i ZRRE-së për tarifat dhe ngarkesat e reja.

Udhëzime lidhur me aplikacionin

Aplikacioni Juaj duhet të marrë parasysh udhëzimet në vijim:

- Duke pasur parasysh transaksionin e KEDS-it dhe, në bazë të Ligjeve të reja, mundësinë për kalimin e të gjithë konsumatorëve jo-shtëpiakë në kategorinë e konsumatoreve të privilegjuar-kualifikuar, tarifat e furnizimit me shumicë të energjisë elektrike, tarifat e

shfrytëzimit të sistemit të shpërndarjes (SHSSH), si dhe tarifave të rregulluara me pakicë, duhet të vendosen ndaras. Të Licencuarit duhet të sigurojnë që aplikacionet e tyre të përmbajnë propozime përkatëse për secilën kategori të tarifave dhe të ngarkesave.

- Gjatë shqyrtimit të SHTE5, ZRRE-ja do të vazhdojë t'i përcaktojë dhe aprovojë tarifave me pakicë për të gjitha kategoritë e konsumatorëve. Në ndërkohë ZRRE-ja do të hartojë kritere për të vlerësuar zhvillimin e konkurrencës në treg, që do të shërbejë si bazë vlerësuese nëse duhet të rregullohen apo jo tarifave të një kategorie të caktuar të konsumatorëve në pajtim me legjislacionin në fuqi.
- Bilanci i energjisë i paraqitur si pjesë e aplikacioneve të tarifave duhet të jetë në përputhje me atë të miratuar nga MEM-i për vitin e ardhshëm. Çfarëdo devijimi nga ky bilanc i miratuar duhet të justifikohet në mënyrë të plotë.
- Supozimet lidhur me subvencionet e importit duhet të jenë konsistente me Projekt Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës (BKK) për vitin 2011. Aplikacioni po ashtu duhet të reflektojë ndryshimet në mes të subvencioneve të supozuara dhe atyre të realizuara gjatë vitit të kaluar.
- ZRRE-ja ka kërkuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) që të sqarojë bazën e vendimit në lidhje me taniemat e ardhshme të linjitet dhe zbatimin e këtij vendimi, të nxjerrë nga Bordi i tij të shtatorit 2010. Pas marrjes së sqarimit nga KPMM-ja, ZRRE-ja do të ofrojë udhëzime për të licencuarit në lidhje me trajtimin e taniemave të linjitet në aplikacionin e tyre të tarifave.
- ZRRE-ja do t'i publikojë aplikacionet e tarifave të marra nga të licencuarit së bashku me vlerësimin e ZRRE-së për to. Për këtë arsye, të Licencuarit duhet të identifikojnë pjesët e aplikacioneve të tyre të cilat i konsiderojnë konfidenciale dhe të cilat nuk duhet të bëhen publike nga ZRRE-ja.

Ju lutemi që për çdo informacion shtesë të na kontaktoni pa hezitim.

Me respekt,

Dr. Ali Hamiti

Kryesues i Bordit të ZRRE-së